

ORGANI SHQYRTUES I PROKURIMIT

Sipas Nenit 109 të Ligjit nr. 04/L-042 për Prokurimin Publik të Republikës së Kosovës, i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin Nr. 04/L-237, ligjin Nr. 05/L-068 dhe ligjin Nr. 05/L-092

Një ankesë kundër: **KUVENDI KOMUNAL VITI**

Për Aktivitetin e Prokurimit Nr. i AP: **657-26-3129-2-1-1**

Sa i përket tenderit për **Shërbimet e Mirëmbajtjes; LOT I, Mirëmbajtja dhe servisimi i automjeteve zyrtare dhe LOT.II, Mirëmbajtja dhe servisimi i gjeneratorëve. -Ritender**

ANKESË

1. Identifikimi i ankuesit*

Shëno emrin e plotë të kompanisë suaj	Gentian Sakaj B.I.
NUI	811044833
Adresa	Rruga "Skenderbeu" p.n.
Vendi	Suharekë
Kodi postar	23000
Numri Telefonit	+383 49547005
Emri i plotë i përfaqësuesit të kompanisë suaj	Gentian Sakaj
Adresa elektronike	gentiautoservis2016@gmail.com
Data e parashtrimit të ankesës	17.07.2026

**Ankues do të thotë një palë e interesuar për parashtrim të ankesës.*

2. Identifikimi i avokatit

Parashtruesi i ankesës mund ta parashtroj ankesën vetëm ose përmes avokatit të tij. Nëse ankesa parashtrohet përmes avokatit, atëherë duhet bashkangjitur autorizimin e përfaqësimit me PROKURË.

Shëno të dhënat si në vijim:

Emri i avokatit
Adresa e plotë
Numri i Telefonit
Numri i faks-it
Adresa elektronike

3. Të dhënat mbi aktivitetin e prokurimit

Shëno një përshkrim të shkurtër lidhur me datën dhe vendin në të cilën është publikuar “ Njoftimi për Kontratë” apo “Njoftimi për konkurs të projektimit” dhe, nëse aplikohet “Njoftimi për dhënie të Kontratës” “Njoftimi për Rezultatet e Konkursit të Projektimit”, apo “Njoftimi për anulim të aktivitetit të prokurimit”, nëse aplikohet, afatin e fundit për dorëzimin e tenderit, datën dhe orën e fillimit të procesit për Hapjen e Tenderëve, si dhe kriteri për dhënie të kontratës:

Ankesa i përket grupeve:

Shërbimet e Mirëmbajtjes; LOT I, Mirëmbajtja dhe servisimi i automjeteve zyrtare - Ritender][LOT.II, Mirëmbajtja dhe servisimi i gjeneratorëve.

Shërbimet e Mirëmbajtjes; LOT I, Mirëmbajtja dhe servisimi i automjeteve zyrtare dhe LOT.II, Mirëmbajtja dhe servisimi i gjeneratorëve. -Ritender

Njoftimi për kontratë: 07.05.2026

Afati për dorëzimin e ofertave: 26.05.2026 13:00

Njoftimi mbi vendimin e AK: 02.07.2026 13:44

4. Procesi i Hapjes së tenderëve, nëse aplikohet

A keni marrë pjesë në procesin e Hapjes së tenderëve? Nëse po, specifikoni shkurtimisht ecurinë e procesit të Hapjes së Tenderëve.

Po ☐

Jo ☒

5. Njoftimi mbi Eliminimin e Tenderuesve, nëse aplikohet

A jeni njoftuar me shkrim lidhur me eliminimin tuaj nga pjesëmarrja e mëtutjeshme në aktivitetin e prokurimit ?

Po ☐

Jo ☒

6. Zgjidhja preliminare e mosmarrëveshjeve

A keni bërë kërkesë për rishqyrtim pranë AK lidhur me arsyet e eliminimit tuaj?

Po ☒

Jo ☐

Nëse po, ofroni detaje mbi këtë fakt dhe bashkëngjit një kopje të vendimit të miratuar nga AK gjatë kontestit paraprak të zgjidhjes së mosmarrëveshjeve në përputhje me nenin 108A të LPP-se.

Kërkesë për rishqyrtim - Kërkesë për rishqyrtim të vendimit: 07.07.2026 12:03

Vendimi i AK në Kërkesën për rishqyrtim: VENDIM.015.GENTIAN.S..pdf data: 10.07.2026 14:13

7. Dispozitat e shkelura nga Autoriteti Kontraktues

Specifikoni dispozitën ose dispozitat e LPP-së që supozohet të jenë shkelur nga Autoriteti Kontraktues që nga momenti i publikimit të Njoftimit për Kontratë/Konkurs të Projektimit, dhe nëse aplikohet gjerë në përmbylljen e këtij aktiviteti të prokurimit me publikimin e Njoftimit për Dhënien e Kontratës apo Njoftimit për Rezultatet e Konkursit të Projektimit apo Njoftimit për Anulim.

Neni 7 - Barazia në Trajtim/ Jo-Diskriminimi (LPP)

Neni 59 - Ekzaminimi, Vlerësimi dhe Krahësimi i Tenderëve (LPP)

Neni 60 - Kriteret për Dhënien e Kontratës (LPP)

Neni 69 - Aftësia Teknike dhe/ose Profesionale (LPP)

Si dhe:

UDHËZUES Nr. 002/2024, PËR PLOTËSIM NDRYSHIMIN E UDHËZUESIT Nr. 001/2023 PËR PROKURIMIN PUBLIK.

*** Sipas Nenit 118 të LPP, OSHP-ja do të kthej tarifën tuaj nëse ankesa aprovohet si e bazuar. OSHP-ja mund të kërkojë një gjabë shtesë deri në 5,000 Euro në rastet kur OSHP-ja konstaton që të gjitha apo cilado nga pretendimet e parashtruara në ankesë kanë qenë e rrejshme ose mashtruese.*

8. Deklaratë detale mbi faktet dhe argumentet

Përshkruani rrethanat faktike që përbëjnë supozimin për shkeljen e dispozitave të LPP-së. Ofroni deklaratë të qartë dhe të detajuar për faktet dhe argumentet të cilat mbështesin secilën bazë të ankesës tuaj.

Me datë 26.05.2026 kemi dorëzuar ofertën për këtë aktivitet të prokurimit, konform të gjitha kushteve dhe kriterëve të dosjes së tenderit për LOT-1 me Titulli: Shërbimet e Mirëmbajtjes; LOT I, Mirëmbajtja dhe servisi i automjeteve zyrtare dhe LOT.II, Mirëmbajtja dhe servisi i gjeneratorëve. -Ritender me numër prokurimi: 657-26-3129-2-1-1.

Kërkesa për rishqyrtim parashtrohet për LOT 1.

Me 02.07.2026 14:29 kemi pranuar Letrën Standarde për Tenderuesit e eliminuar dhe Njoftim mbi Vendimin e AK për rekomandim me kontratë Operatorin Ekonomik (OE) D.P.Z. "GOLF", POZHERAN.

Me datë 03.07.2026 na është lejuar qasja në dokumentacionin zyrtar dhe pas shqyrtimit të Ofertës të OE të rekomanduar për kontratë, në bazë të dokumentacionit duke krahasuar e kërkesat si në dosjen e tenderit dhe njoftimit për kontratë kemi konstatuar se Komisioni Vlerësues kundërligjshëm ka rekomanduar për fitues një OE të papërgjegjshëm.

Në bazë të dokumentacionit duke krahasuar e kërkesat si në dosjen e tenderit dhe njoftimit për kontratë kemi konstatuar se Komisioni Vlerësues kundërligjshëm ka rekomanduar për anulim të procedurës me këto shkelje:

Pretendimi 1:

Sipas Seksioni II. Fleta e të Dhënave të Tenderit (FDT) të Dosje të Tenderit (DT) ashtu dhe në Njoftimin për Kontratë (NJK), kriteri: 1. Kontratave të shërbimeve të ngjashme, që Operatorit ekonomik ka realizuar në tri vitet e fundit. Minimum vlera 155,000.00 € .Në rast të Grupit Lideri të përmbush 60% të kriterëve. Dëshmia e kërkuar dokumentare:

1. Lista e kontratave të shërbimeve të ngjajshme kontrata të realizuara nga Operatorit ekonomik ose grup Operatorësh, bashke me referencen (në rast të grupit, Lideri të përmbush 60% të kriterëve).

OE i propozuar për kontratë ka dorëzuar “Lista e Kontratave të realizuara në vitet e fundit” si dhe dëshmitë e referencave të kontratave sipas listës. Nga Lista e dorëzuar OE i propozuar për kontratë ka dorëzuar këto referenca:

- Referenca me numër rendor 2 sipas Listës së dorëzuar, referenca nga: Spitali i përgjithshëm Gjilan, me titull: Ri Tenderim – Servisimi dhe Mirëmbajtja e Automjeteve në SP Gjilan, me vlerë: 14,891.70 euro.

- Referenca me numër rendor 4 sipas Listës së dorëzuar, referenca nga Kuvendi Komunal Viti, me vlerë 82,925.00 euro, si dhe

- Referenca me numër rendor 6 sipas Listës së dorëzuar, referenca nga Qendra për Shëndet Mental - Gjilan, me vlerë 7,828.65 euro

Për tre vitet e fundit OE ka dëshmuar se ka realizuar kontrata me referenca në vlerë totale prej 105,645.35 euro që kjo vlerë nuk e plotëson kriterin e kërkuar prej 155,000.00 euro.

Në Listën e dorëzuar nga OE i propozuar për kontratë, ka paraqit Kontrata që janë Në realizim si dhe kontrata të përfunduara në vitin 2020. Këto kontrata nuk mund të dëshmohen me Referenca si dhe nuk janë për tre vitet e fundit sipas kërkesës për plotësim kriteri.

Komisioni vlerësues ka bërë shkelje të UDHËZUES Nr. 002/2024, PËR PLOTËSIM NDRYSHIMIN E UDHËZUESIT Nr. 001/2023 PËR PROKURIMIN PUBLIK, Neni 10 - 10. Sqarimi i tenderëve gjatë procesit të vlerësimit të tenderëve, Paragrafi 10.1 Shembujt e mëposhtëm nuk janë të vetmet raste. Varësisht nga rasti i paraqitur AK duhet të veproj në përputhje me nenin 72 dhe nenin 59 të LPP-së,

Problemi: Lista e kontratave të realizuara e dorëzuar nuk përmbush kërkesat minimale të vlerës se përcaktuar; Si të veprohet? Refuzo tenderin pa kërkuar informacion të mëtejshëm.

Komisioni vlerësues e ka anashkaluar këtë fakt dhe ka vazhduar me vlerësimin e tenderit deri në rekomandim për kontratë. Është mëse e qartë se mos-përmbushja e kërkesës minimale të vlerës së përcaktuara të referencave, tenderi duhet të refuzohet.

OE i rekomanduar për kontratë NUK është i përgjegjshëm sepse referencat e dorëzuara NUK e plotësojnë kushtin minimal të kërkuar.

Pretendimi 2

Sipas Seksioni II. Fleta e të Dhënave të Tenderit (FDT) të Dosje të Tenderit (DT) ashtu dhe në Njoftimin për Kontratë (NJK), kriteri: 2) Lista e punetoreve minimum 7, Sipas evidencat e OE të vulosur dhe nënshkruar. SE paku 2(dy) puntor të çertifikuar për mbrojtje të shëndetit dhe siguri në punë dhe së paku 2(dy) puntor të trajnuar për mbrojtje nga zjarri. Dëshmia e kërkuar dokumentare: 2.) Të sjell dëshmi mbi punetoret sipas kërkesa se bashke me kontratat dhe dëshmit tjera.

OE i propozuar për kontratë ka dorëzuar Parakontrata me punëtorët: Kushtrim Misini, Egzon Misini, Alban Sahiti, Jup Avdyli dhe Rizah Avdiu.

Në këto Parakontrata të prezantuara NUK janë paraqitur Numrat Personal të punëtorëve, datëlindjet apo vendbanimet e tyre. Këto Parakontrata mund të jenë fiktive sepse nuk ka asnjë element që dëshmon të dhënat personale të Punëmarrësit.

Gjithashtu, NUK vërtetohet se ndonjëri prej punëtorëve posedon Certifikatën për mbrojtje

te Shëndetit dhe siguri në punë si dhe nuk ka dëshmi se posedojnë trajnime për mbrojtje nga Zjarri sipas kërkesës për plotësim kriteri në FDT.

Ky kriter NUK është i plotësuar nga OE i rekomanduar për kontratë.

Pretendimi 3:

Sipas Seksioni II. Fleta e të Dhënave të Tenderit (FDT) të Dosje të Tenderit (DT) ashtu dhe në Njoftimin për Kontratë (NJK), kriteri: Kërkesa 3 Operatori Ekonomik duhet që të ketë Objektin – Punëtorinë për servisimin dhe mirëmbajtjen e automjeteve jo më larg se 15 Kilometra nga Objekti i Autoritetit Kontraktues, bazuar në rrugën me të afërt tokësore të asfaltuar.) Garazha të disponoj, minimum 3 vinqa, për riparimin e mjeteve motorike.

Shënim Te drejte ofertimi kanë të gjithë Operatorët Ekonomik, pa marrë parasysh se në cilin vende apo lokalitet kanë selinë e regjistrimit të kompanisë por bazuar në parimin e efikasitetit dhe ekonomicitetit, Operatorët Ekonomik që ofertojnë duhet që Objektin – Punëtorinë për servisimin dhe mirëmbajtjen e automjeteve që kanë në pronësi apo ta marrin me qira, ta kenë jo më larg se 15 Kilometra nga Objekti i Autoritetit Kontraktues, bazuar në rrugën me të afërt tokësore të asfaltuar. Dëshmia e kërkuar dokumentare: Dëshmia 3 Nëse Objekti - punësia është në pronësi si dëshmi kërkohen kopjet e dokumentacionit të pronësisë. Nëse objekti- punësia është marrë me qira si dëshmi kërkohet kopja e kontratës së qirasë. Te sjell dëshmi për sipas kërkesës, garazha të mos jetë në diametër më larg se 15 km.

OE i propozuar për kontratë ka dorëzuar Certifikatë prone për Njësinë Kadastrale: P-73701026-01117-0.

Kjo njësi kadastrale me numër P-73701026-01117-0 NUK ekziston fare në regjistrin e Agjencisë Kadastrale të Kosovës.

Fleta poseduese e lëshuar me datë 20.04.2023 NUK e vërteton se në të njëjtën sipërfaqe është e ndërtuar garazha për servisim të automjeteve sipas kërkesës.

Ky kriter NUK është i plotësuar nga OE i rekomanduar për kontratë.

Pretendimi 4:

Pas administrimit dhe shqyrtimit të shkresave të lëndës, sqarojmë se OE i rekomanduar për kontratë ka dorëzuar ofertë me çmime manipulative për disa pozicione. OE i rekomanduar për kontratë ka manipuluar me këto pozicione:

Pjesa B, Pozicioni nr. 15 – Pllakat e frenimit (para), çmimi më i lirë në këtë pozicion është 5 euro për disa nga automjetet ndërsa më i larti është 350 euro për disa tjera.

Pjesa B, Pozicioni nr. 16 – Pllakat e frenimit prapa, çmimi më i lirë në këtë pozicion është 5 euro për disa nga automjetet ndërsa më i larti është 350 euro për disa tjera.

Pjesa B, Pozicioni nr. 26 – Cilindri i frenimit të rrotës së pasme, çmimi më i lirë në këtë pozicion është 5 euro për disa nga automjetet ndërsa më i larti është 250 euro për disa tjera.

Pjesa B, Pozicioni nr. 44 – Cilindri i kvaqilles, çmimi më i lirë në këtë pozicion është 5 euro për disa nga automjetet ndërsa më i larti është 150 euro për disa tjera

Pjesa B, Pozicioni nr. 54 – Llamelle e lidhëses, çmimi më i lirë në këtë pozicion është 5 euro ndërsa më i larti është 500 euro për disa tjera, dallimi shumë i madh.

Pjesa B, Pozicioni nr. 75 – Llamella korpa drugllageri, çmimi më i lirë në këtë pozicion është 20 euro për disa nga automjetet ndërsa më i larti është 550 euro për disa tjera.

Pjesa B, Pozicioni nr. 105 – Turbina, çmimi më i lirë në këtë pozicion është 5 euro për disa nga automjetet që është çmim ekstremisht i ulët ndërsa më i larti është 400 euro për disa tjera.

Pjesa B, Pozicioni nr. 118 – Injektori, çmimi më i lirë në këtë pozicion është 5 euro për disa nga automjetet që është çmim ekstremisht i ulët ndërsa më i larti është 400 euro për

disa tjera.

Pjesa B, Pozicioni nr. 129 – Pistoni (klipi), çmimi më i lirë në këtë pozicion është 5 euro për disa nga automjetet që është çmim ekstremisht i ulët ndërsa më i larti është 450 euro për disa tjera që është çmim ekstremisht i lartë.

Të njëjtën metodë manipulative OE i propozuar për kontratë e ka përdor dhe në pozicionet: Pjesa B, Pozicioni nr. 184 – Pompa hidraulike e timonit dhe në shumë pozicione të tjera.

Si përfundim në rastin konkret pasi që OE i rekomanduar për kontratë D.P.Z.

“GOLF”, POZHERAN ka vendosur çmime manipulative për të zbritur Çmimin e Përgjithshëm i peshuar dhe dyshojmë se ka qenë në dijeni se cilat automjete realisht kanë nevojë për servisim dhe ka vendosur çmim astronomik të lartë ndërsa për ato automjete që nuk kanë nevojë për servisim (riparim) ka vendos çmim jo normalisht të ulët.

Me këtë veprim Komisioni i Vlerësimit ka bere shkelje te nenit 1 te LPP-së ku thuhet se: vendimet e AK-ve, të mos ndikohen nga interesat personale, të karakterizohet me jodiskriminim dhe me një shkallë të lart të transparencës dhe, të jenë në përputhje me kërkesat procedurale dhe qenësore të këtij ligji.

Pretendimi 5:

Në lidhje me refuzimin e tenderit tonë me arsyen se: Ju nuk keni plotësua kërkesat sipas FDT, **Mungon dëshmia e objektit në diametrin e kërkuar**, ju sqaroj se:

Ne si OE me rastin e tenderimit kemi dorëzuar Deklaratë ku kemi deklaruar se: nëse ne si OE tenderues jemi kompani më e favorshme ekonomikisht dhe kompani pretendent për firmosje te kontratës, deklarojmë se: PARA NJOFTIMIT MBI VENDIMIN E AUTORITETIT KONTRAKTUES DO TË MARRIM OBJEKT ME QIRA BRENDA 15 KILOMETRAVE NGA OBJEKTI I AK DHE DO TI SJELLIM TË GJITHA DOKUMENTET E KËRKUARA SIPAS KRITERIT.

Bazuar në paragrafin 2 të Nenit 59 - Ekzaminimi, Vlerësimi dhe Krahassimi i Tenderëve, 2. Autoriteti kontraktues mundet që me shkrim të kërkojë nga një tenderues që të sigurojë një sqarim me shkrim mbi cilindo nga aspektet e tenderit të tij, në mënyrë që të bëhet ekzaminimi, vlerësimi ose krahasimi i tenderëve. Asnjë ndryshim material dhe asnjë aspekt i tenderit nuk duhet të kërkojen ose pranohen nga autoriteti kontraktues ose të ofrohen nga një tenderues, ju si AK meqenëse nuk ka ndryshim material, mund të kërkon sqarim në lidhje me këtë kriter. Gjithashtu bazuar në po të njëjtin Nen, paragrafi 4. Autoriteti kontraktues do të konsiderojë një tender si të përgjegjshëm vetëm nëse tenderi në fjalë është në përputhshmëri me të gjitha kërkesat e parashtruara në njoftimin e kontratës dhe në dosjen e tenderit. Pavarësisht nga e mëparshmja, autoriteti kontraktues mund të konsiderojë një tender si të përgjegjshëm nëse: (i) përmban vetëm gabime ose paqartësi të cilat mund të korrigjohen pa ndryshuar kushtin material apo aspekin e tenderit në fjalë, ose (ii) përmban vetëm devijime të vogla që nuk mund të shkaktojnë ndryshime materiale ose devijime nga karakteristikat, kushtet, dhe kërkesat e tjera të parashtruara në njoftimin e kontratës dhe në dosjen e tenderit; me kusht që, çfarëdo devijimi i tillë të kuantifikohet, aq sa është e mundshme, dhe të merret parasysh gjatë vlerësimit dhe krahasimit të tenderëve, ju si AK mund ta konsideroni tenderin tonë si të përgjegjshëm pasi që paqartësi mund të korrigjohen pa ndryshuar kushtin material apo aspekin e tenderit në fjalë. Nëse neve si OE tenderues na kërkohej që të dëshmojmë

marriten e një garazhe për servisim me qira, ne si oe do të sjellim këtë dëshmi brenda afatit ligjor për sqarime të tenderit.

Me rastin e eliminimit të kompanisë sonë duke mos kërkuar sqarim, shihet qartas që ka vepruar në kundërshtim me Rregulloren nr.002/2024 për plotësimin dhe ndryshimin e rregullores nr.001/2022 për prokurimin publik 40.13-Duke mos bërë vlerësimin dhe krahasimin e tenderëve sipas kritereve për dhënien e kontratës të përcaktuara nënjoftimin e kontratës/dosjen e tenderit. Ndërsa, duke e ditur që ne si tenderues kemi ofruar ofertën më të mirë sipas kritereve për dhënien e kontratës, në bazë të Rregullores për prokurim publik, 45.33, Autoriteti Kontraktues ka vazhduar vlerësimin e ofertës jashtë kritereve të cilat nuk kanë qenë të vendosura në dosjen e tenderit dhe njoftimin për kontratë. Ndërsa neni 59.4 i LPP-së gjithashtu lejon Autoritetin Kontraktues që të pranojë ofertat, në rast të gabimeve ose paqartësive dhe në raste të devijimeve të vogla. Në të dyja rastet është një kusht që të mos jetë në aspektin material të njoftimit për kontratë/dosjen e tenderit nuk janë prekur. Ndërsa duke u bazuar në Nenin 59-Ekzaminimi, Vlerësimi dhe Krahasimi i tenderëve pika.2 AK ka mundur që të kërkojë sqarim me shkrim mbi cilindo nga aspektet e tenderit, në mënyrë që të bëhet Ekzaminimi, Vlerësimi ose Krahasimi i tenderëve sipas Ligjit, Udhëzueseve dhe Rregulloreve.

Komisioni i vlerësimit me rastin e vlerësimit ka bërë shkeljen e deklaratës nën betim Sipas Neneve 1,11, 59 dhe 72 të Ligjit Nr. 04/L-042 për Prokurimin Publik të Republikës së Kosovës, i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin Nr. 04/L-237, ligjin Nr. 05/L-068 dhe ligjin Nr. 05/L-092 duke mos zbatuar detyrën për të cilën edhe e ka nënshkruar këtë deklaratë duke eliminuar kompaninë tonë për kritere të kanë mundur të kërkojë sqarim.

Me eliminimin tonë nga ky aktivitet i prokurimit dhe me shpalljen fitues të OE, AK e ka favorizuar drejt për se drejt OE të rekomanduar për kontratë ndërsa na ka diskriminuar dhe na ka dëmtuar neve drejtpërsëdrejti.

Përfundim

Duke u bazuar në të gjitha faktet që u cekën më lartë kërkojmë nga AK që ta rishqyrtoni edhe një herë vendimin sepse është në kundërshtim me dispozitat e Ligjit Nr. 04/L-042 PËR PROKURIMIN PUBLIK TË REPUBLIKËS SË KOSOVËS, I ndryshuar dhe plotësuar me Ligjin Nr. 04/L-237, Ligjin Nr. 05/L-068 dhe Ligjin Nr. 05/L-092 (Versioni i Konsoliduar), konkretisht e:

Neni 7 - Barazia në Trajtim/ Jo-Diskriminimi (LPP)

Neni 59 - Ekzaminimi, Vlerësimi dhe Krahasimi i Tenderëve (LPP)

Neni 60 - Kriteret për Dhënien e Kontratës (LPP)

Neni 69 - Aftësia Teknike dhe/ose Profesionale (LPP)

Si dhe:

UDHËZUES Nr. 002/2024, PËR PLOTËSIM NDRYSHIMIN E UDHËZUESIT Nr. 001/2023 PËR PROKURIMIN PUBLIK.

Pretendimi ynë është i bazuar në dëshmi dhe fakte të cilat lehtësisht mund të verifikohen, dëshmi të cilat i potencuam edhe më lartë, prandaj kërkojmë që NJOFTIM MBI VENDIMIN E AUTORITETIT KONTRAKTUES B58 i këtij tenderi të anulohet dhe të aprovohet kërkesa jonë për rivlerësim të tenderit, dhe pas një vlerësimi korrekt të shpallemi NE si fitues i tenderit në fjalë.

Duke u bazuar në faktet që u përmenden më lartë, kërkojmë nga ju që të shqyrtoni Kërkesën tonë për Rishqyrtim në mënyrë meritore dhe të nxjerrni këtë:

VENDIM

APROVOHET, si e bazuar Kërkesa për Rishqyrtim të Vendimit të OE Gentian Sakaj B.I., të anulohet "Njoftim mbi vendimin e autoriteti kontraktues" për këtë aktivitet të prokurimit dhe njëkohësisht kërkojmë që të ktheni tenderin në rishqyrtimin dhe

rivlerësimin e këtij aktiviteti të prokurimit sipas dispozitave të LPP-së dhe duke u bazuar në kërkesat e FDT-së dhe të njoftimit për kontratë, duke na rekomanduar kompaninë tonë fituese pasi që supozojmë që jemi të kompletuar për këtë projekt.

9. Dëmet materiale

Përshkruaj mënyrën se si shkelja e supozuar i ka shkaktuar ose kërcënohet t'i shkaktojë dëme materiale parashtruesit të ankesës, në rast se përfshini pretendime për kompensim.

Konsiderojme që kemi bërë shpenzime materiale për përgatitjen dhe dorëzimin e ofertës, për kërkesën për rishqyrtim, ankesën si dhe dëmtime tjera në fitimin e pritur, vlerë të referencave, imazh dhe dëmtime tjera që mund të ndodhin

10. Lista e dokumenteve (dëshmime) të bashkangjitura

Nëse aplikohet, bashkëngjitni Ankesës dokumentet e renditura më poshtë:

- a) një kopje të publikimit të “Njoftimit për Kontratë” apo “Njoftimit për Konkurs të Projektimit.
- b) një kopje të publikimit për “Njoftimin e Dhënies së Kontratës” apo “Njoftimin për Rezultatet e Konkursit të Projektimit” apo “Njoftimit për Anulim”.
- c) një kopje të letrës së eliminimit të tenderuesit/kandidatit/ letrës se tenderuesit të pasuksesshëm/ letrës për mos para-kualifikim.
- d) një kopje të procesverbalit të hapjes publike të tenderëve, nëse aplikohet,
- e) bashkëngjit një kopje të vendimit të miratuar nga AK gjatë kontekstit paraprak të zgjidhjes së mosmarrëveshjeve në përputhje me nenin 108A të LPP-se,
- f) Dëshminë e pagesës së tarifës së ankimit në përputhje me nenin 118 të LPP-se, dhe
- g) të gjitha korrespondencat e juaja me autoritetin kontraktues duke përfshirë e-mailat si dhe çdo informatë të shkruar që ka të bëjë me këtë aktivitet prokurimi, si dhe me secilin pretendim të paraqitur në ankesë.

****Sipas Nenit 111.2 të LPP, Parashtruesi i ankesës, origjinalin e ankesës do t'ia dorëzojë OSHP-së dhe njëkohësisht një kopje do t'ia dërgojë në mënyrën më të shpejtë të mundshme Autoritetit Kontraktues.*